

FIGURAT E SHQUARA DHE KONTRIBUTI I TYRE NË FORMËSIMIN E GJUHËS DHE ARSIMIT SHQIP

*Mbi kontributin e rilindasve dhe Stambollin, kryeqendrën e Perandorisë
Osmane*

Prof. Asoc. Dr. Xhemile ABDIU

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Abstrakt

Sami Frashëri, Pashko Vasa dhe Jani Vreto, në shkurt të vitit 1879, botuan librin *Alfabetare e gjuhësë shqip*, në të njëjtin vit kur u themelua edhe Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip. Kjo vepër, me karakter enciklopedik dhe didaktik, konsiderohet si botimi i parë kolektiv i Rilindjes Kombëtare me qëllim mësimin e alfabetit dhe forcimin e vetëdijes kombëtare. Kjo elitë intelektuale, e edukuar dhe me aktivitet në Perandorinë Osmane, përgatiti një libër të thjeshtë për të mësuar alfabetin e shqipes. Botimi anastatik i kësaj vepre, i shoqëruar me shënime filologjike nga studiues bashkëkohorë, ka ndihmuar në rizbulimin e vlerave të saj. Ky artikull shqyrton rolin e Rilindësve Shqiptarë në formësimin e shqipes dhe veprimtarinë e tyre në Stamboll si kryeqendrën e Perandorisë Osmane, në të cilën gjenden vepra të rralla të studiuara tanimë, por edhe vepra të pa studiuara ende që presin të dalin në pah nëpërmjet botimeve anastatike apo studimeve të ndryshme.

Fjalë çelës: gjuha shqipe, elita intelektuale, Stambolli, Rilindja Kombëtare.

Prominent figures and their contribution to the shaping of the Albanian Language & Education *On the Contribution of the Renaissance and Istanbul, the Capital of the Ottoman Empire*

Abstract

In February 1879, Sami Frashëri, Pashko Vasa, and Jani Vreto published *Alfabetare e gjuhësë shqip*, the same year the Society for the Publication of Albanian Letters was founded. This work, with both encyclopedic and didactic elements, is considered the first collective cultural publication of the Albanian National Awakening, aimed at teaching the Albanian alphabet and fostering national awareness. This intellectual elite, educated and active in Istanbul, contributed significantly to the codification of the Albanian language. The facsimile (anastatic) edition of the work, accompanied by philological commentary from contemporary scholars, has renewed scholarly interest in its value. This article explores the role of the Albanian Renaissance figures in shaping the language and their cultural activity in Istanbul, which served as a hub of Albanian intellectual life in the 19th century. Special attention is given to the importance of identifying and studying other unpublished works from the period, which remain valuable yet overlooked sources for Albanological research.

Keywords: Albanian language, intellectual elite, Istanbul, National Renaissance.

Hyrje

Pas pushtimit të Stambollit nga osmanët në vitin 1453, Gadishulli i Ballkanit u shndërrua në një vend të rëndësishëm për Perandorinë Osmane. Të gjitha zhvillimet historike dhe ndryshimet që ndodhën në Perandorinë Osmane sollën një realitet të ri për vendet e Ballkanit. Në Gadishullin e Ballkanit osmanët ndërtuan shumë vepra arkitekturore si xhami, ura, medrese, saraje, hamame etj. dhe me përhapjen e Islamit përhapën edhe gjuhën turke. Fillimisht ky ishte një ndikim thjesht gjuhësor i një kulture dhe i një qytetërimi të panjohur më parë, që solli me vete edhe koncepte të reja për jetën e shoqërisë ballkanase. Më pas, ky ndikim vijoi me përhapjen e traditës, kulturës dhe letërsisë që sollën me vete osmanët. Perandoria Osmane, që pati mundësinë të jetonte duke i kapërcyer bashkëkohësit e vet, la një trashëgimi shumë të pasur, që përfshin shumë aspekte të jetës sociale dhe shpirtërore të shoqërisë.²⁶³

Stambolli, kryeqendra e Perandorisë Osmane ishte vendi ku jetoi, u arsimua dhe u zhvillua elita e Rilindjes sonë Kombëtare, e cila kontribuoi me vepra të jashtëzakonshme për gjuhën dhe kulturën osmane dhe njëkohësisht për gjuhën dhe kulturën e shqiptarëve.

Në fundin e shekullit të 19-të Perandoria Osmane hyri në fundin e epokës së saj dhe popujt e ndryshëm brenda perandorisë u përpoqën të siguronin ekzistencën e tyre të pavarur. Edhe shqiptarët u vunë në lëvizje për të siguruar ekzistencën e tyre përballë rrezikut të shembjes së Perandorisë Osmane dhe copëtimit të trojeve të tyre nga Fuqitë e Mëdha. Në dhjetor të vitit 1877, në Stamboll u formua Komiteti Kombëtar me emrin "Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombit Shqiptar" i njohur si Komiteti i Stambollit. Sipas historianes Nuray Bozborra një nga detyrat kryesore për secilin nga anëtarët e Komitetit të Stambollit ishte sensibilizimi i qarqeve zyrtare osmane dhe atyre europiane për mbrojtjen e kombit shqiptar dhe njohjen e së drejtës së tij legjitime për një status politik dinjtoz.²⁶⁴ Por, mes kërkesave politike, ishte edhe kërkesa kulturore për shtrirjen e sistemit arsimor dhe përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë shkollë.²⁶⁵

Komiteti i Stambollit mori përsipër çështjen e njësimin të alfabetit të shqipes. Për këtë caktoi një komision që do të hartonte alfabetin e përbashkët të gjuhës shqipe. Anëtarët e këtij komisionit ishin personalitete politike, kulturore dhe shkencore. Ky komision kryesohej nga Sami Frashëri, hartuesi i Fjalorit të Turqishtes Kamus'i Turki 1889-1900, gjuhëtari, enciklopedisti dhe mendimtari i madh i njohur në Stamboll me emrin Shemsedin Sami. Në përbërje të komisionit ishin Pasko Vasa, Hasan Tahsini, Jani Vreto dhe Koto Hoxhi. Këta intelektualë të shkolluar në Perandorinë Osmane, njerëz të kulturuar dhe zotërues të shumë gjuhëve perëndimore dhe lindore bënë të gjitha përpjekjet e mundshme në gjirin e Perandorisë Osmane, në Stamboll, për alfabetin e përbashkët të shqipes.

Analizë

Më 10 qershor të vitit 1878 rrethanat historike mundësuan krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila në programin e saj nuk harroi kurrsesi fushën kulturore dhe rëndësinë e përhapjes së shkrimit të gjuhës shqipe si gjuhë amëtare e shqiptarëve. Pa ekzistencën e gjuhës amtare nuk mund të krijohesh ndërgjegjja kombëtare si dhe bindja se shqiptarët duhet të kishin shtetin e tyre të pavarur ashtu si shtetet e tjera të Ballkanit. E gjithë veprimtaria politike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit mbështetej në dy kolona të rëndësishme: lufta për ruajtjen e tërësisë tokësore dhe përpjekjet për bashkimin e tokave shqiptare në një njësi administrative autonome si shkallë kalimtare për krijimin e shtetit kombëtar të pavarur.²⁶⁶ Vetë marrëdhëniet që u krijuan me Stambollin gjatë luftës kundër aneksimit të tokave shqiptare nga fqinjët do të inkurajonin radikalizimin e qëndrimit të Lidhjes Shqiptare ndaj Shtetit Osman dhe qartësimin e thellimin e kërkesave për të drejta politike kombëtare. Kërkesa për bashkimin e

²⁶³ Abdiu, Xhemile, "Letërsia orientale në këndvështrimin e sotëm të studimeve të letërsisë shqipe në hapësirën mbarëshqiptare", *Philosophica, International Journal of Social and Human Sciences*, 1/2014, *Philosophica*, Vol.1, Nr.1-2, 2014, f.237-240.

²⁶⁴ Nuray Bozborra, *Osmanlı Yönetiminde Arnavutluk, Arnavut Ulusçuluğunun Gelişimi*, İstanbul: Boyut Kitapları, 1997, f.170.

²⁶⁵ Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 174.

²⁶⁶ Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (Studime e Dokumente)*, Tiranë: UET Press, 2009, f. 400.

trojeve shqiptare në një vilajet të vetëm autonom, me nëpunës që të dinin shqip, me arsim në gjuhën amtare, me organ më të lartë Kuvendin e Përgjithshëm, i cili do të merrte vendime dhe do të miratonte reforma të dobishme për tërë vendin dhe ku një pjesë e mirë e të ardhurave të vilajetit do të përdreshin për arsimin dhe ekonominë, u shprehën në disa memorandume të ndryshme dërguar Stambollit nga forumet e Lidhjes së Prizrenit gjatë viteve 1878-1880.²⁶⁷

Ishte Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip, e cila njihet edhe si Shoqëria e Shkronjësive ose Shoqëria e Stambollit, e themeluar në Stamboll në Tetor të vitit 1879, e cila mori përsipër detyrën për krijimin e një alfabeti të gjuhës shqipe. Kjo shoqëri ndikoi në zgjimin kombëtar të shqiptarëve që njihet në histori si Rilindja Kombëtare Shqiptare. Intelektualët që themeluan Shoqërinë e të Shtypuri Shkronja Shqip ishin nga të gjithë trevat e Shqipërisë pa dallim fetar, të përkatësisë myslimane dhe të krishterë, të cilët përbënin elitën intelektuale në Stambollin e atëhershëm dhe kishin spikatur me veprimtarinë e tyre intelektuale dhe kombëtare në gjirin e Perandorisë Osmane dhe për Perandorinë Osmane.

Sipas historianit Ferit Duka, shteti osman nuk ishte i interesuar për dobësimin e faktorit shqiptar në Ballkan. Shembuj domethënës në këtë drejtim janë rastet e inkurajimit të disa veprimtarive kulturore e arsimore që synonin të bënin të njohur historinë dhe identitetin e shqiptarëve nëpër Europë. Si ilustrim për këtë mund të sillen sponsorizimi i botimit në gjuhën frënge të veprës së Pashko Vasës "E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët" (1879).²⁶⁸ Sipas studiuesve turq përfaqësja e shtetit osman ndaj kësaj çështjeje gjatë këtij procesi nuk ishte e pavarur nga zhvillimet ndërkombëtare dhe dinamikat e brendshme politike dhe sociale të Perandorisë.²⁶⁹

Intelektualët shqiptarë arritën të themelojnë në kryeqendrën e Perandorisë Osmane, në Stamboll, shoqërinë e parë kulturore të shqiptarëve jashtë atdheut që ishte Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip me karakter kulturor dhe arsimor. Dhe kuptohet që kishte rëndësi politike dhe kulturore sepse ndihmoi lëvizjen tonë kombëtare për autonominë dhe më pas pavarësinë e Shqipërisë.

Statuti për themelimin dhe qëllimet e Shoqërisë, u botua në Mecmu'a-i Ulum. Siç e përmendëm më sipër kryetar i Shoqërisë ishte Sami Frashëri (Şemsettin Sami). Ndërsa Hoxhë Tahsini, Naim Frashëri, Jani Vreto, Pandeli Sotiri, Ibrahim Starova (Temo), Koto Hoxhi ishin ndër themeluesit e Shoqërisë. Komisioni zgjodhi si të përshtatshëm alfabetin e paraqitur nga Sami Frashëri prandaj është quajtur Alfabeti i Stambollit ose Alfabeti i Sami Frashërit. Sami thoshte se "puna e shoqërisë sonë është të ngjallurit e gjuhës shqipe dhe të bashkuarit të dialekteve të saj e të dritësuarit të kombit tonë, që është një punë shumë e vlejtur dhe e shenjtëruar".

Statuti i Shoqërisë e të Shtypuri Shkronja Shqip përbëhej nga 25 nene dhe të tërheq vëmendjen fakti se në hyrje të tij theksohet se të gjitha kombet e qytetëruara kanë arritur qytetërimin duke shkruar dhe duke lexuar në gjuhën e tyre. Kjo përfaqëse është trajtuar mbi bazën e qytetërimit dhe të prosperitetit.²⁷⁰ Në këtë statut tërheq vëmendjen fakti se anëtarët e Shoqërisë pranoheshin si të barabartë, pa dallim feje dhe secti.

Intelektualët shqiptarë që jetonin në Stamboll si Şemsettin Sami, Hoxhë Tahsini, Naim Frashëri, Jani Vreto, Pandeli Sotiri, Ibrahim Starova (Temo), Koto Hoxhi e shumë të tjerë i dhanë përparësi gjuhës shqipe dhe kishin si qëllim shtypjen e veprave në gjuhën shqipe. Rilindasit shqiptarë shkruan dhe debatuan në shtypin e Stambollit të asaj kohe për këto ngjarje të rëndësishme për gjuhën shqipe.

Në çerekun e fundit të shekullit të 19-të në Perandorinë Osmane ishte krijuar një rrjet shumë i fuqishëm me shkolla të huaja. Gjuha shqipe ishte e fundit ndër gjuhët që u mësua si gjuhët e tjera dhe që u fut në programin e shkollave shtetërore. Pas shpalljes së Kushtetutës në vitin 1908 u vendos që shqipja të mësohej si gjuhët e tjera dhe u fut në programin e shkollave shtetërore. Çështja e alfabetit u pasqyrua gjerësisht në shtypin osman me qendër në Stamboll. U la në dëshirën e shqiptarëve zgjedhjen e shkronjave për të shkruar në gjuhën shqipe mes veprave të shkruara me alfabetë të ndryshëm. Çështja e alfabetit të gjuhës shqipe është një nga çështjet më delikate

²⁶⁷ Po aty, f. 401.

²⁶⁸ Duka, Ferit, *Themelimi i Komitetit të Stambollit: Sfondi Politik*, f. 32; cituar Kristaq Prifti "Botimi dhe përhapja në Europë e veprës së Pashko Vasës "E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët"", *Studime Historike*, 2002 (1-2), f. 51-60

²⁶⁹ Ünver Metin, *Osmanlı Belgelerine göre Arnavut Alfabesi ve Arnavut Dilinin Öğretilmesi*, Aktet e Konferencës Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip 1879-2019, Alsar, Tiranë, 2024, f. 34.

²⁷⁰ "Cemiyeti-i İlmîye-i Arnavudîye Nizamnamesi", Mecmua-I Ulum, No. 3, İstanbul, 1 Muharrem 1297, f. 217.

të studiuara, çështje për të cilën ka ende burime në arkivat e Stambollit për t'u sjellë në vëmendjen e lexuesit nga studiuesit e rinj dhe të pasionuar pas kësaj teme. Sjellim në vëmendje dy citime nga punimet e dy studiuesve turq pjesëmarrës në konferencën Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip 1879-2019 që u mbajt në Tiranë me rastin e 140 vjetorit të krijimit të Shoqërisë së të Shtypuri Shkronja Shqip nën kujdesin e Fondacionit ALSAR për të risjellë në vëmendje ngjarje të rëndësishme në historinë e Rilindjes sonë Kombëtare të ndodhur në Stambollin e asaj kohe, në kryeqendrën e Perandorisë Osmane.

Sipas studiuesve turq "qëndrimi që ka mbajtur shteti osman duke filluar nga çereku i fundit të shekullit 19-të ndaj gjuhës shqipe dhe arsimit të shqiptarëve nuk ka qenë kurrë në të njëjtin drejtim, por është ndikuar së tepërmi nga zhvillimet sipas periudhave, nga zhvillimet politike të brendshme dhe të jashtme. Kështu ndërsa në vitin 1878 ka mbështetur Lidhjen e Prizrenit dhe ka inkurajuar përhapjen e alfabetit të Stambollit, më vonë, për shkak të zhvillimeve të reja, ka qenë i detyruar të veprojë në një linjë të ndryshme. Në një rajon gjeografik shumë të gjerë dhe midis këtyre ndryshimeve, edhe populli shqiptar me tipare të ndryshme fetare dhe kulturore ka zënë vendin e tij si faktor i rëndësishëm. Politika arsimore që shteti zbatoi ndaj shqiptarëve asnjëherë nuk ka qenë në një nivel më të ulët nga ajo e ndjekur ndaj popujve të tjerë që jetonin në Perandorinë Osmane".²⁷¹ Një tjetër studiues turk, Şamil Mutlu shprehet se "Shqiptarët që kishin ndarë fatin e tyre dhe ishin shkrirë me Shtetin Osman ishin të fundit që për motive të ndryshme braktisën anijen. Ndërsa shqiptarët, që kishin nxjerrë burra shteti të mëdhenj dhe njerëz të ditur, patën fatin e keq se lufta e tyre në fushën e arsimit përkoi në të njëjtën kohë me periudhën kur shtetet europiane rrethuan në aspektin politik dhe kulturor Shtetin Osman. Është shumë e rëndësishme të theksohet se udhëheqësit e periudhës pas Kushtetutës i trajtuan kërkesat e shqiptarëve për arsimin në gjuhën shqipe si një nevojë e Kushtetutës dhe u përpoqën të bëjnë rregullimet e nevojshme në përputhje me të. Ndonëse shqiptarët patën mundësinë e arsimit në gjuhën amtare pas popujve të tjerë, trajtimi nga ana e shtetit e kërkesës së tyre si një e drejtë kushtetuese dhe marrja e masave në këtë drejtim fatkeqësisht ndodhën në të njëjtën kohë me procesin e shpërndarjes së shqiptarëve."²⁷²

Një tjetër figurë intelektuale si Hasan Kaleshi shkruan për jehonën që pati çështja e Alfabetit të Stambollit në shtypin turk dhe debatet në Stamboll në gazetatat turke kryesisht në gazetatat Tann e Tesvir-i Efkâr, Zaman, İkdâm, Yeni Gazete, La Tourquie Nouvelle, ku vihet re, sipas tij, një liri e madhe e të shfaqurit të mendimeve në shtypin e atëhershëm turk.²⁷³

Sjellim në vëmendje botimin anastatik të librit "Alfabetare e gjuhës shqipe" nga Fondacioni ALSAR, libër që është një vlerë e shtuar në bibliografinë për çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe. Kopja e alfabetares gjendet në bibliotekën e veprave të rralla të Universitetit të Stambollit në Stamboll. Gjithashtu kjo është vepra e njëmbëdhjetë në serinë e botimeve anastatike të Fondacionit ALSAR. Libri i titulluar "Alfabetare e gjuhës shqipe" i shkruar në një alfabet të vetëm, i njohur edhe si Alfabeti i Stambollit, që do ta miratonte pas disa muajsh Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip si alfabet të përbashkët kombëtar, u botua në shkurt të vitit 1879 nga elita e asaj kohe Jani Vreto, Pasko Vasa dhe Sami Frashëri. Rëndësia e këtij libri qëndron në faktin se është libri i parë i kësaj natyre në gjuhën shqipe dhe se deri në vitin 1879 nuk kishin botuar ndonjë shkrim në gjuhën shqipe. "Alfabetare e gjuhës shqipe" është vepra e parë kolektive e Rilindjes sonë Kombëtare.

Konkluzione

Arkivat e Stambollit, kryeqendrës së Perandorisë Osmane, kanë ende dokumente që presin të studiohen dhe të hulumtohen nga studiuesit shqiptarë dhe turq për të sjellë të dhëna të reja të pashfrytëzuara më parë për atë periudhë të pasur me zhvillime politike, kulturore dhe shoqërore. Bashkëpunimet institucionale ndërmjet akademikëve dhe studiuesve shqiptarë e turq do të nxjerrin në pah dokumentacionet arkivore të pashfrytëzuara më parë mes dy vendeve. Kontributi i rilindësve tanë në Stamboll, në periudhën më kritike të Perandorisë Osmane

²⁷¹ Ünal, Metin, Alfabeti shqip dhe mësimi i gjuhës shqipe sipas dokumenteve osmane, f. 53

²⁷² Mutlu Şamil, *Veprimtarite arsimore të shqiptarëve pas shpalljes së kushtetutës*, f. 151.

²⁷³ Hysa, Enver, *Rreth Botimit të Vëllimit "Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip"*, f. 206

dhe të Rilindjes sonë kombëtare ka lënë gjurmë të rëndësishme në gjuhën dhe kulturën e të dy vendeve, me vepra të cilat kanë përcaktuar edhe vendin e tyre në histori.

Literatura

- AIITC. (2009). *Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*. Tiranë. (Botim origjinal: IRCICA, 2001).
- Aktet e Konferencës *Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip 1879–2019*. (2024). Tiranë: ALSAR.
- Bozbor, N. (2002). *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Tiranë: Dituria.
- Bozbor, N. (1997). *Osmanlı Yönetiminde Arnavutluk: Arnavut Ulusçuluğunun Gelişimi*. İstanbul: Boyut Kitapları.
- Frashëri, S. (2004). *Vepra I – Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhetë*. Shkup: Logos-A.
- Hysa, E., Lafe, E., & Mancaku, S. (2020). *Alfabetare e Gjuhësë Shqip – Në Stamboll më 1879* (botim anastatik dhe transkriptim në alfabetin e sotëm, me rastin e 140-vjetorit të Shoqërisë së të Shtypuri Shkronja Shqip). Tiranë: ALSAR.
- Lafe, E., & Lloshi, Xh. (Përg.). (2019). *Shoqëri e të Shtypuri Shkronja Shqip dhe veprimtaria e saj (1879–2019): Përmbledhje studimesh dhe artikujsh me rastin e 140-vjetorit të themelimit*. Tiranë: ALSAR.
- ALSAR. (2019). *Botim anastatik i kopjes së alfabetares që Sami Frashëri ia dhuroi Sulltan Abdulhamidit II*. Tiranë: ALSAR.
- Mutlu, Ş. (2024). Meşrutiyet sonrası Arnavutların eğitim faaliyetleri ve Hürriyet Mektebi. Në *Aktet e Konferencës Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip 1879–2019* (fq. 153–164). Tiranë: ALSAR.
- Ünver, M. (2024). Osmanlı belgelerine göre Arnavut alfabesi ve Arnavut dilinin öğretilmesi. Në *Aktet e Konferencës Shoqëria e të Shtypuri Shkronja Shqip 1879–2019* (fq. 33–53). Tiranë: ALSAR.